



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 65 Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 17 / 04 / 2025

**VENDIM**

Nr.11, datë 17 /04 /2025

**NË LIDHJE ME KONTROLLIN SHTETËROR TË SIGURISË SË DIGAVE TË MËDHA NGA  
MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QË MBULOJNË FUSHËN E QËLLIMIT TË  
SHFRYTËZIMIT TË TYRE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave", Neni 10 si dhe të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Për Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Neni 4, dhe neni 5, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 17.04.2025 diskutoi në lidhje me mungesën e informacionit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) si dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) në lidhje me rezultatet e kontrollit të tyre për sigurinë e digave të mëdha në përputhje me kërkesat e legjislacionit të përmendur me sipër. Sipas informacionit të marrë nga ITD, deri në fund të muajit Mars 2025, nuk ka ardhur asnjë informacion nga MIE dhe MBZHR apo Institucionet në varësi të tyre të cilat mbulojnë fushën e qëllimit të ndërtimit të digës dhe i shfrytëzojnë ato nëpërmjet ndërmarrjeve shtetërore të varësisë, dhënies me koncesion, bordeve të kullimit apo shoqatave. Gjithashtu, pranë MIE ose institucioneve të saj të varësisë rezulton se nuk ka asnjë grup të sigurisë së digave me përbërje inxhinierë të kërkuar në nenin 5 të VKM së mësipërme. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM ,

**VENDOSI:**

- 1- Ti kërkohet MIE që brenda muajit Qershor 2025 të dërgojnë pranë KKDM një informacion zyrtar për rezultatet e kontrollit të sigurisë së digave të mëdha dhe dambave që janë pjesë e ndërmarrjeve shtetërore apo janë dhënë me koncesion në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Në këtë informacion duhet të përfshihet edhe informacioni për institucionin në varësi të kësaj Ministrie që mbulon fushën e qëllimit të ndërtimit dhe shfrytëzimit të digave ekzistuese që përdoren për prodhim energjie dhe për furnizimi me ujë si dhe për dambat. Në këtë informacion duhet të jepen edhe të dhënat për grupin e sigurisë së këtyre digave pranë Institucioneve të varësisë sipas kërkesave të nenit 5 të VKM së mësipërme.
- 2- Ti kërkohet MBZHR që mbulon fushën e qëllimit të ndërtimit dhe shfrytëzimit të digave të mëdha për ujitje dhe peshkim të dërgoj, brenda muajit Qershor 2025, pranë KKDM, informacionin e nevojshëm me rezultatet e kontrollit të tyre gjatë vitit 2024 për gjëndjen, shfrytëzimin, monitorimin dhe sigurinë e digave të mëdha që përdoren për ujitje dhe peshkim sipas kërkesave të ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000, neni 10 dhe VKM Nr.147, datë 18.03.2004, neni 4.
- 3- Të informoj Këshillin e Ministrave për mungesën e këtij informacioni nga të dy Ministrinë e linjës në lidhje me rezultatet e kontrollit të sigurisë së digave gjatë vitit 2024.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për zbatimin e këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

**PËR KOMITETIN KOMBËTAR TË DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**

